



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 23.01.2019

VENDIM

Nr. 4, datë 23.01.2019

**PËR
RREGULLORE PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE STUDENTORË NË UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI" VLORË**

Në mbështetje të shkronjës **d**, pikës **1**, neni **38** në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 23.01.2019

VENDOSI:

1. Të kthejë për rishikim projekt-rregulloren për zgjedhjen e këshillave studentorë në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë në nenet si më poshtë vijon:
 - a. Neni 4/7, ndarja e anëtarëve sipas fakulteteve ka gabime. Në shpërndarjen e numrit të merren për bazë programet e studimit të ofruara nga njësitë dhe numri i studentëve për to. Për Fakultetin e Shkencave Teknike, ndarja e propozuar është: Departamenti i Fizikës dhe ai i Kimisë mund të përfaqësohen me 1 (një) anëtar, i Matematikës me 1 (një) anëtar, i Biologjisë me 2 (dy), i Shkencave Detare me 1 (një), i Shkencave Kompjuterike me 2 (dy), i Inxhinierive dhe Teknologjisë me 2 (dy).
 - b. Neni 4/4, për Fakultetin e Shkencave Humane, ndarja e propozuar është: Departamenti i Drejtësisë 3 (tre) anëtarë, i Edukimit 3 (tre) anëtarë, i Gjuhëve të Huaja 2 (dy) anëtarë, Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë 1 (një) anëtar.
 - c. Neni 4/11 të formulohet "Në rastin kur për anëtar në Këshillat Studentore të Fakulteteve kandidon një student i vetëm, për të fituar ai duhet të sigurojë **50% +1** të votuesve që kanë votuar".
 - d. Neni 12 ka papajtueshmëri me nenin 29. Nuk përcaktohet kush mban procesverbalin dhe kush zgjidhet sekretar.
 - e. Neni 29. Të përcaktohet vendi/selia se ku do të bëhet konstituimi dhe thirrja e mbledhjes së parë.
 - f. Materiali ka nevojë për redaktim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Vendimi i përcillet grupit hartues të rregullores.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

